



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

Nr. 6 (J) 2025 i Regjistrit Themeltar

Nr. 18 i Vendimit

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Illir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare
Asim Vokshi,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

me sekretare Anjeza Puka, në datën 10.02.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare publike kërkesën nr. 6 (J) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **JO MË PAK SE NJË E PESTA E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,** të përfaqësuar nga deputeti Gazment Bardhi dhe avokati Marash Logu.

SUBJEKT I INTERESUAR:
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Genci Gjonçaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 57/2025, datë 16.09.2025 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi i vendimit nr. 57/2025, datë 16.09.2025 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, deri në dhënien e një vendimi përfundimtar.

BAZA LIGJORE: Nenet 1, 2, 7, 75, 76, 78, 83, 131, 132 dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të jo më pak se një të pestës së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004 (*vendimi nr. 166/2004*), Kuvendi, bazuar në nenin 75, pika 2, të Kushtetutës, ka miratuar Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Rregullorja*), e cila ka përcaktuar rregullat e organizimit dhe funksionimit të

Kuvendit për organet drejtuese, mbledhjet e komisioneve dhe seancave plenare, procedurën ligjvënese, kontrollin parlamentar, monitorimin e procesit për integrimin evropian, zgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e organeve kushtetuese dhe të institucioneve të krijuara me ligj, interpretimin dhe ndryshimin e Rregullores, imunitetin parlamentar, transparencën dhe shërbimet e tij.

2. Në datën 15.09.2025, me fillimin e legjislaturës së re pas zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare, pesë deputetë të Kuvendit, anëtarë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, bazuar në nenin 75, pika 2, të Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 117 të Rregullores, kanë paraqitur propozimin për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 166/2004 të Kuvendit.

3. Me vendimin nr. 55/2025, datë 16.09.2025, Kuvendi, në mbështetje të neneve 28, dhe 55 të Rregullores, me kërkesë të nënshkruar nga 30 deputetë të Partisë Socialiste, ka vendosur të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar propozimin për disa ndryshime në vendimin nr. 166/2004, duke caktuar shqyrtimin e tij në seancën plenare të po asaj dite. Për rrjedhojë, me vendimin nr. 56/2025, datë 16.09.2025, Kuvendi, në mbështetje të neneve 55, pika 1 dhe 117 të Rregullores, ka vendosur ndryshimin e rendit të ditës të asaj seance plenare, duke shtuar si pikë edhe shqyrtimin e ndryshimeve të Rregullores. Pas çeljes së seancës plenare dhe votimit për shqyrtimin e propozimit me procedurë të përshpejtuar, ajo është ndërprerë dhe projektvendimi i ka kaluar për shqyrtim Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin (*Këshilli për Rregulloren*). Po atë ditë, Këshilli për Rregulloren ka miratuar projektvendimin në parim, nen për nen dhe në tërësi, dhe i ka paraqitur Kryetarit të Kuvendit raportin e tij (me dy qëndrime të kundërta, atë të shumicës dhe atë të pakicës parlamentare, sipas diskutimeve në procesverbalin e mbledhjes), si dhe projektvendimin bashkëlidhur.

4. Me riçeljen e seancës plenare, Kuvendi, me vendimin nr. 57/2025, datë 16.09.2025 (*vendimi nr. 57/2025*), ka miratuar ndryshimet në vendimin e tij nr. 166/2004 dhe më konkretisht: në pikën 1 të nenit 19 të Rregullores është ndryshuar numri i komisioneve të përhershme të Kuvendit nga 8 në 11, me emërtimet dhe fushat e përgjegjësisë si vijon: (i) Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat (*Çështjet e politikave ekonomike me përqasjen ndaj tregut të përbashkët evropian, Buxhetin e Shtetit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij, marrëdhëniet e punësimit, lirisë së lëvizjes së punëtorëve, financat publike, privatizimet dhe sistemin bankar*); (ii) Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike (*Kodet dhe ligjet, duke garantuar përputhshmërinë dhe zbatueshmërinë e tyre me standardin evropian; organizimin e pushtetit gjyqësor dhe raportimin e tij, administratën e pushtetit gjyqësor; administratën publike, institucionet e pavarura në sistemin e drejtësisë*); (iii) Komisioni për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes (*Çështjet e brendshme, të rendit, organizimin e*

mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare e publike, organizimin e Forcave të Armatosura dhe bashkëpunimin ushtarak, çështjet e organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor, emergjencat civile dhe mbrojtja nga fatkeqësitë, shërbimet sekrete); (iv) Komisioni për Edukimin, Shkencën dhe Sportet (Çështjet në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, inovacionit dhe politikat e zhvillimit të sportit); (v) Komisioni për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale (Çështjet lidhur me politikat shëndetësore, sigurimet shoqërore, familjen, gruan dhe çështjet për mirëqenien sociale; (vi) Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm (Çështjet në fushën e energjisë, burimeve natyrore dhe biodiversitetit, infrastrukturën, industrinë dhe telekomunikacionin, rregullimin e territorit, tregtinë dhe mbrojtjen e mjedisit dhe çështjet për zhvillimin e qëndrueshëm); (vii) Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik (Çështjet në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, çështjet lidhur me veprimtarinë e mediave audiovizive dhe informimit dhe çështjet për garantimin e lirisë së shprehjes); (viii) Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural (Çështjet e bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit, çështjet e zhvillimit rural, çështjet e kontrollit dhe garantimit të sigurisë ushqimore, monitorimin e zbatimit të politikave në fushën e bujqësisë dhe të sigurisë ushqimore); (ix) Komisioni për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën (Çështjet e kulturës kombëtare dhe trashëgimisë kulturore; zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm; politikat për ruajtjen e identitetit kulturor e gjuhësor të diasporës dhe të pjesëmarrjes së saj në proceset politike dhe sociale në vend); (x) Komisioni për Evropën dhe Punët e Jashtme (Çështjet e integritetit evropian, përafrimi i legjislacionit me legjislacionin e Bashkimit Evropian; mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, mbikëqyrja e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Shqipërinë; monitorimi i negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian, politikat e jashtme, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare); (xi) Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale (Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të strategjive, rezolutave, vendimeve dhe planeve të veprimit të Kuvendit, shqyrtimi dhe ndjekja e nismave të qytetarëve dhe peticioneve; realizimi dhe koordinimi, mbikëqyrja dhe kontrolli i zbatimit të ligjeve nga ekzekutivi, institucionet dhe agjencitë e pavarura prej tij, përmes koordinimit të procesit parlamentar për kontrollin post-legjislativ (PLS); koordinimi i dialogut dhe bashkëpunimit ndër-institucional).

Po kështu, është shfuqizuar edhe pika 3 e nenit 20 të Rregullores që parashikonte mundësinë e anëtarëve të Komisionit të Integritetit Evropian për të qenë anëtarë edhe në komisione të tjera.

5. Në datën 23.09.2025, një grup prej 39 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve, kanë vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese

(Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 57/2025 të Kuvendit, si të papajtueshëm me Kushtetutën, duke kërkuar edhe pezullimin e tij. Kolegji i Gjykatës në datën 07.11.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

6. Me vendimin e datës 03.12.2025, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e kërkuarit për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 57/2025 të Kuvendit, në kuptim të parashikimeve të nenit 45 të Ligjit Organik të Gjykatës, me shumicë votash¹, ka vendosur rrëzimin e saj si të pabazuar, pasi ka vlerësuar se argumentet e parashtruara në mbështetje të këtij kërkitimi kanë natyrë të përgjithshme, duke mos arritur të provohen pasojat e rënda, të pariparueshme dhe reale nga zbatimi i vendimit objekt kërkesë.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuar**, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar si vijon:

i) *Për juridiksionin e Gjykatës*

7.1. Çështja hyn në juridiksionin e Gjykatës, për shkak se Rregullorja, e parashikuar nga neni 75, pika 2, i Kushtetutës, është akt normativ i ndryshëm nga rregullorja e brendshme e parashikuar nga neni 76, pika 3, i Kushtetutës. Në këtë kuptim edhe vendimi i Kuvendit për ndryshimet e Rregullores, sipas vetë jurisprudence të Gjykatës, duhet të kundërshtohet përpara saj.

ii) *Për themelin e çështjes* kërkuar ka pretenduar se vendimi nr. 57/2025 i Kuvendit cenon:

7.2. *Parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve*, të sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës, pasi miratimi i ndryshimeve të Rregullores, për sa i takon strukturës, numrit, emërimit, përbërjes dhe drejtimit të komisioneve të përhershme, është bërë vetëm pesë ditë pas fjalimit të Kryeministrit në Asamblenë Kombëtare të Partisë Socialiste dhe në kushtet kur legjislatura e re nuk ishte mbledhur akoma. Kjo vendimmarrje përbën një ndërhyrje flagrante të pushtetit ekzekutiv në kompetencat e pushtetit legjislativ.

7.3. *Parimin e demokracisë përfaqësuese në drejtim të lirisë së shprehjes*, pasi deputetëve të pakicës parlamentare u është hequr e drejta e fjalës nga Kryetari i Kuvendit për diskutimin e projektvendimit për ndryshimin e Rregullores, në

¹ Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi për pranimin e kërkesës për pezullim, ndërsa gjyqtaret Fiona Papajorgji dhe Marsida Xhaferllari votuan për shqyrtimin e kësaj kërkesë në seancë plenare.

kundërshtim me të drejtat që burojnë nga statusi i deputetit, nga vetë Rregullorja, si dhe nga interpretimi sistematik i neneve 1, 2, 70 dhe 75 të Kushtetutës.

7.4. *Procedurën e shqyrtimit të përshpejtuar*, pasi neni 83, pika 2, i Kushtetutës përcakton se Kuvendi me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një të pestës të të gjithë deputetëve mund të shqyrtojë e të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së përshpejtuar, dispozitë që reflektohet edhe në nenin 28 të Rregullores. Sipas nenit 117 të Rregullores edhe ndryshimi i saj ndjek të njëjtën procedurë dhe afate, ashtu si edhe për ligjet. Rregullorja është miratuar në kundërshtim me këto dispozita, brenda së njëjtës ditë (më 16.09.2025), me procedurë të përshpejtuar.

7.5. *Mënyrën e thirrjes së mbledhjes së Kuvendit*, pasi neni 78, pika 2, i Kushtetutës parashikon se mbledhjet që janë thirrur në kundërshtim me Rregulloren nuk sjellin asnjë pasojë. Në këtë kuadër neni 27/1, pika 3, i Rregullores parashikon se mbledhjet e Kuvendit njoftohen si rregull 7 ditë përpara, por në çdo rast jo më vonë se 2 ditë përpara datës së caktuar për seancë plenare. Në interpretim të dispozitës, si dhe në referim të praktikës parlamentare, do të kuptohej se 2 ditë është minimumi që lejon Rregullorja për njoftimin e rendit të ditës. Në këtë këndvështrim, afatet e njoftimit të mbledhjes së Kuvendit nuk përbëjnë thjesht dhe vetëm një aspekt formal të punës, por kanë si qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së deputetëve dhe dhënien atyre mundësi të diskutojnë për të kontribuar efektivisht në procesin ligjvënës. Në kundërshtim me sa parashikohet në aktet e sipërcituara, thirrja e mbledhjes plenare është bërë me urdhrin e datës 15.09.2025, pra vetëm 1 ditë nga seanca e datës 16.09.2025, seancë kjo që është zhvilluar në orën 10:00 dhe 17:00.

8. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtuar si vijon:
i) Për juridiksionin e Gjykatës

8.1. Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e vendimit objekt kërkesë, pasi ai ka si objekt ekskluziv organizimin e brendshëm të Kuvendit dhe nuk rregullon marrëdhënie juridike të përgjithshme, nuk prodhon pasoja ndaj subjekteve jashtë Kuvendit dhe nuk prek drejtpërdrejt të drejta ose liri themelore të individëve. Ky akt përbën shprehje të drejtpërdrejtë të nenit 75, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilit Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve. Në këtë kuptim, ndryshimet e miratuara janë pjesë e sovranitetit organizativ të Kuvendit, një element thelbësor i ndarjes së pushteteve, që nuk mund

të interpretohet si i kufizuar përtej rasteve kur konstatohet cenim real i parimeve kushtetuese themelore.

ii) Për themelin e çështjes

- 8.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve* nuk është ngritur në nivel kushtetues. Neni 7 i Kushtetutës sanksionon ndarjen dhe balancimin mes pushteteve dhe nuk ndalon në asnjë rast bashkëveprimin dhe komunikimin mes tyre, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret. Nga ana tjetër, ushtrimi i nismës për ndryshimin e Rregullores i takon vetë Kuvendit dhe në këtë aspekt nisma për ndryshim ka ardhur nga një grup deputetësh të shumicës në ushtrim të së drejtës së tyre. Gjithashtu, nuk është kryer asnjë lloj ndërhyrjeje nga ana e ekzekutivit që të cenojë kompetencat kushtetuese të deputetëve dhe Kuvendit, pasi Kryeministri ka ushtruar të drejtën e tij për të komunikuar me opinionin publik dhe me anëtarët e forcës së tij politike.
- 8.3. Pretendimi për cenimin e *parimit të demokracisë përfaqësuese* është i pabazuar. E drejta e fjalës së deputetëve është sanksionuar në nenet 46 dhe 48 të Rregullores, duke vendosur rregulla të qarta për ushtrimin e saj, por pa krijuar një të drejtë absolute. Nga ana tjetër, Kushtetuta dhe Rregullorja bëjnë një dallim për sa i takon mënyrës së miratimit të projektligjeve dhe akteve të tjera ku përfshihen edhe projektvendimet si në rastin konkret, e lidhur kjo dhe me rëndësinë e secilit akt, për sa kohë ligjet kanë karakter të përgjithshëm dhe rregullojnë marrëdhënie sociale, ekonomike etj., ndërkohë që vendimi për ndryshimin e Rregullores është një akt me karakter të brendshëm organizativ. Edhe praktika e deritanishme parlamentare ka treguar se në disa raste janë bërë ndryshime pa u zhvilluar debat dhe në kohë relativisht të shkurtër si në rastin konkret. Fakti që deputetët e pakicës parlamentare nuk kanë qenë dakord me ndryshimet dhe me shpejtësinë e procesit, nuk përbën në vetvete një shkelje kushtetuese. Gjithashtu, referuar nenit 76, pika 2, të Kushtetutës, Kryetari i Kuvendit ka, ndër të tjera, edhe kompetencën për të drejtuar debatin dhe për t'u dhënë fjalën deputetëve dhe në rastin konkret vendimi i tij për të mos hapur diskutime nuk përbën shkelje të së drejtës së fjalës, por një vendim të marrë në ushtrim të kompetencave të tij kushtetuese dhe bazuar në një praktikë parlamentare të konsoliduar.
- 8.4. Pretendimi për shqyrtimin me *procedurë të përshpejtuar* nuk qëndron. Interpretimi i nenit 83, pika 2, të Kushtetutës nga ana e kërkuarit është i gabuar, pasi Rregullorja në vetvete është një akt *sui generis* me natyrë të brendshme organizative dhe jo një

ligj në kuptimin formal kushtetues dhe, në këtë kuptim, dispozita kushtetuese rregullon procedurën e përshpejtuar vetëm për projektligjet. Edhe Rregullorja e reflekton këtë qasje kushtetuese, duke rregulluar procedurën e përshpejtuar vetëm për projektligjet. Ndërkohë, pavarësisht se neni 117 i Rregullores përcakton se për shqyrtimin e propozimeve për ndryshime në Rregullore ndiqet procedura e parashikuar për projektligjet, ky rregull nuk mund të lexohet si një imponim absolut i çdo detaji procedural të shqyrtimit të projektligjeve, veçanërisht kur Rregullorja parashikon rregulla të veçanta për kategorinë e aktit objekt shqyrtimi. Për më tepër, shtyrja e afatit me 1 javë mekanikisht do të vononte fillimin e punës së komisioneve të Kuvendit.

- 8.5. Pretendimi për cenimin e *procedurës së thirrjes së Kuvendit* nuk qëndron. Ka një dallim konceptual midis thirrjes së mbledhjes sipas Rregullores dhe respektimit të afateve procedurale të njoftimit, kjo pasi neni 78, pika 2, i Kushtetutës, i cituar nga kërkuesi, lidhet me rastet kur Kuvendi mbledhet pa u thirrur fare, kur mungon akti i thirrjes nga organi kompetent ose kur mbledhja zhvillohet pa kuorum ose jo në vendin e mbledhjes. Në rastin konkret mbledhja është thirrur rregullisht nga Kryetari i Kuvendit dhe vetëm fakti që është thirrur brenda një afati më të shkurtër nuk përbën shkelje të nenit 78, pika 2, të Kushtetutës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

9. Gjykata, lidhur me juridiksionin e saj për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve me natyrë kushtetuese, ka pohuar se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, sipas të cilit: “1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. 2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.”. Kjo dispozitë kushtetuese përcakton funksionin themelor të saj, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese, ndërkohë që juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës, ku veçanërisht neni 131 parashikon kompetencën kushtetuese sipas natyrës së çështjes. Në këtë kuptim, koncepti “mosmarrëveshje kushtetuese” në nenin 124 të Kushtetutës e merr përmbajtjen e tij dhe përfshin çështjet kushtetuese që janë të parashikuara jo vetëm nga neni 131 i Kushtetutës, por edhe nga çdo dispozitë tjetër kushtetuese,

mbi bazën e të cilave Gjykata ushtron kompetencat e saj (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata vëren se ajo është vënë në lëvizje për shqyrtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të dispozitave të Rregullores së Kuvendit, e cila *prima facie* nuk rezulton të jetë e përfshirë në mënyrë të shprehur në kategorinë e akteve me natyrë normative që bëjnë pjesë në rendin e brendshëm juridik dhe as në përmbajtjen e nenit 131 të Kushtetutës ose të dispozitave të tjera kushtetuese që përcaktojnë kompetencat e Gjykatës në drejtim të çështjeve që ajo merr në shqyrtim. Po kështu, Gjykata ka vlerësuar se në respektim të parimit të vetërregullimit të Kuvendit, ky akt, në parim, nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues dhe se mosrespektimi i Rregullores e bën veprimtarinë parlamentare antikushtetuese vetëm nëse janë prekur dispozita të nivelit kushtetues, që gjejnë pasqyrim në të, ndërsa për çështje të tjera ajo nuk mund të jetë objekt i kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 48, datë 19.06.2024; nr. 1, datë 16.02.2022; nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, për shkak të natyrës *sui generis* të këtij akti, i cili nuk ka natyrë të mirëfilltë normative në kuptim të përmbajtjes së neneve 116 dhe 131 të Kushtetutës dhe as natyrë tipikisht individuale, çështja e juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e këtij akti është vënë edhe më parë në diskutim në jurisprudencën kushtetuese.

11. Në drejtim të juridiksionit kushtetues për kontrollin e pajtueshmërisë së këtij akti me Kushtetutën edhe palët në gjykim kanë mbajtur qëndrime të ndryshme. Kështu, sipas kërkuessit, çështja hyn në juridiksionin kushtetues për shkak se Rregullorja e parashikuar nga neni 75, pika 2, i Kushtetutës, është akt normativ i ndryshëm nga rregullorja e brendshme e parashikuar nga neni 76, pika 3, i Kushtetutës. Për rrjedhojë, sipas kërkuessit, vendimi i Kuvendit për ndryshimet e Rregullores, objekt kërkesë, mund t'i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se Rregullorja është një akt *sui generis*, me natyrë të brendshme organizative dhe jo një ligj në kuptimin formal kushtetues, ndaj vendimi i Kuvendit që ka miratuar disa ndryshime në këtë akt nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues. Sipas Kuvendit, Kushtetuta parashikon dy rregullore, respektivisht sipas neneve 75, pika 2 dhe 76, pika 3 të saj dhe e para (Rregullorja) nuk rregullon marrëdhënie juridike të përgjithshme, nuk prodhon pasoja ndaj subjekteve jashtë Kuvendit dhe nuk prek drejtpërdrejt të drejta ose liri themelore të individëve.

12. Për sa më sipër, Gjykata çmon të verifikojë edhe në rastin konkret nëse ka juridiksion për të ushtruar kontrollin e pajtueshmërisë së aktit objekt kërkesë me Kushtetutën, duke u ndalur në vlerësimin e natyrës së këtij akti, natyrës së pretendimeve të parashtruara nga kërkuessi, në kuptimin sesi ato lidhen me norma dhe parime kushtetuese, për të evidentuar nëse ekziston një mosmarrëveshje kushtetuese.

13. Rregulloja, që sipas nenit 75, pika 2, të Kushtetutës miratohet nga shumica e të gjithë anëtarëve të këtij organi, është një akt juridik që ka si qëllim të vendosë rregulla për veprimtarinë dhe funksionimin e brendshëm të këtij organi. Ajo është burim i rezervuar i së drejtës kushtetuese që disiplinon procedurën për zhvillimin e punimeve të Kuvendit, organizimin e brendshëm, raportet midis vetë Kuvendit si tërësi e organizmave të tij të brendshëm, raportet e tij me organet e tjera kushtetuese etj. *(shih vendimet nr. 1, datë 16.02.2022; nr. 44, datë 07.10.2011; nr. 29, datë 21.10.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*. Një pjesë e normave të Rregullores kanë përmbajtje të njëjtë ose detajojnë normat kushtetuese dhe, për këtë shkak, marrin natyrë të veçantë dhe mund të sjellin edhe pasoja të nivelit kushtetues *(shih vendimin nr. 48, datë 19.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*. Për shkak të natyrës *sui generis* dhe qëllimit të saj, Rregullorja nuk është përfshirë në mënyrë të shprehur në juridiksionin kushtetues ose në atë të zakonshëm gjyqësor, për sa kohë rregullon çështje që kanë të bëjnë me organizimin e Kuvendit, pra në respektim të parimit të autonomisë parlamentare. Gjithsesi, duke qenë se ky akt prek norma kushtetuese që mund të krijojnë mosmarrëveshje, bazuar edhe në parimin se në një shtet të së drejtës aktet e miratuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së organeve të pushtetit publik nuk mund të lihen jashtë kontrollit kushtetues në rast se ato prekin të drejta dhe parime të parashikuara nga normat kushtetuese, Gjykata ka vlerësuar se ka juridiksion për të shqyrtuar edhe pajtueshmërinë me Kushtetutën të Rregullores së Kuvendit *(shih vendimin nr. 48, datë 19.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*.

14. Edhe pse Kuvendi gëzon një shkallë të gjerë lirie për të vendosur për rregullat që kërkohen me qëllim vetorganizimin, në mënyrë që të garantojë kryerjen e duhur të punëve, kufiri ndërmjet këtij parimi dhe atij të kushtetutshmërisë, i cili detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese, vihet nën mbrojtjen e kësaj Gjykate, e cila mund dhe duhet të investohet sa herë përpara saj paraqiten për zgjidhje mosmarrëveshje kushtetuese për shkak të cenimit të parimeve kushtetuese dhe të lirive themelore. Për rrjedhojë, pa vënë në diskutim pavarësinë e Kuvendit si organi që miraton dhe interpreton Rregulloren në ushtrim të pushtetit vetërregullues sipas nenit 75, pika 2, të Kushtetutës, kompetenca e Gjykatës për kontrollin e këtij akti kufizohet vetëm në pretendime kushtetuese dhe ushtrohet ndaj atyre dispozitave që prekin normat kushtetuese *(shih vendimin nr. 48, datë 19.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*.

15. Në këtë pikë, Gjykata çmon të evidentojë edhe faktin se Rregullorja objekt shqyrtimi, e miratuar sipas nenit 75, pika 2, të Kushtetutës, ka një dallim të qartë nga rregullorja e brendshme që normon shërbimet e tjera të nevojshme për funksionimin e Kuvendit nga pikëpamja mbështetëse administrative, sipas nenit 76, pika 3, të Kushtetutës, e cila përbën

tipikisht një akt rregullator të brendshëm. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se Kushtetuta, ndërsa këtë lloj rregulloreje (të fundit) e përcakton shprehimisht për çështje të rregullimit të brendshëm, Rregullores i referohet për çështje të organizimit dhe funksionimit të Kuvendit, që ashtu siç ka pohuar edhe vetë Gjykata (*shih vendimin nr. 48, datë 19.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), është akt i cili respekton parimin e autonomisë parlamentare të njëjës legjislaturë nga tjetra. Në vijim të jurisprudencës së saj të mëparshme dhe duke konsideruar edhe këtë ndryshim mes këtyre akteve, Gjykata arrin në përfundimin se Rregullorja nuk është akt tipikisht i brendshëm për të rregulluar funksionimin e brendshëm, por një akt atipik, që normon organizimin dhe funksionimin e Kuvendit, pra ka natyrë organike, por është parashikuar në formën e rregullores dhe jo të ligjit për të respektuar autonominë parlamentare të njëjës legjislaturë nga tjetra.

16. Në kuptim të sa më sipër, duke pasur parasysh se natyra e të drejtave që vihen në diskutim dhe e pasojave që vijnë nga përmbajtja e aktit të kundërshtuar janë elementet përcaktuese të juridiksionit kushtetues, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi kanë të bëjnë, në thelb, me kufizimin e ushtrimit të të drejtave të deputetëve që burojnë nga mandati i tyre kushtetues përfaqësues, në kuptim të neneve 70 dhe 71 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, për sa kohë këto pretendime lidhen me cenimin e të drejtave që burojnë nga normat kushtetuese, dispozitat e Rregullores objekt shqyrtimi përfshihen në juridiksionin kushtetues.

B. Për legjitimimin e kërkuesit

17. Në lidhje me legjitimimin e kërkuesit, Gjykata, bazuar në hapësirën dhe mënyrën e ushtrimit të juridiksionit të saj për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të dispozitave të Rregullores, ka vlerësuar se kriteret e legjitimitetit verifikohen sipas të njëjtave kriteresh që zbatohen në rastet e kontrollit abstrakt të normës, sipas nenit 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “c”, të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 48, datë 19.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata vëren se ajo është vënë në lëvizje nga një subjekt i pakushtëzuar, i parashikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 1, të Ligjit të saj Organik. Gjykata ka theksuar se interesi publik i këtyre funksionarëve publikë është i prezumuar, pasi një kërkesë e tyre vë në lëvizje një kontroll abstrakt e objektiv të aktit normativ dhe interesi që kërkohet të mbrohet lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe me funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës (*shih vendimet nr. 35, datë 15.06.2023; nr. 18, datë 07.07.2022; nr. 55, datë 27.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet si në aspektin formal, ashtu edhe substancial për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

19. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sipas nenit 50, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi dispozitat e kundërshtuara të Rregullores janë miratuar nga Kuvendi në datën 16.09.2025 dhe kanë hyrë në fuqi menjëherë, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 23.09.2025, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar.

20. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Kuvendit për miratimin e ndryshimeve të Rregullores ka cenuar *parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, parimin e demokracisë përfaqësuese në drejtim të lirisë së shprehjes*, dispozitat kushtetuese që normojnë *mënyrën e thirrjes së seancës plenare* të Kuvendit dhe *procedurën e miratimit* të Rregullores.

21. Për pretendimin për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës, kërkuesi ka argumentuar se miratimi i ndryshimeve të Rregullores është bërë vetëm 5 ditë pas fjalimit të Kryeministrit në Asamblenë Kombëtare të Partisë Socialiste dhe në kushtet kur legjislatura e re nuk ishte mbledhur akoma, çka, sipas tij, përbën ndërhyrje flagrante të pushtetit ekzekutiv në kompetencat e pushtetit legjislativ. Subjekti i interesuar, Kuvendi, për këtë pretendim ka prapësuar se ushtrimi i nismës për ndryshimin e Rregullores i takon vetë Kuvendit dhe në rastin konkret ajo ka ardhur nga një grup deputetësh të shumicës parlamentare, sipas kompetencave të tyre. Sipas këtij subjekti, në rastin konkret, nuk është kryer asnjë lloj ndërhyrjeje nga ana e ekzekutivit që të cenojë kompetencat kushtetuese të deputetëve dhe Kuvendit.

22. Neni 7 i Kushtetutës parashikon se sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve në demokraci, si formë e qeverisjes, synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi ose të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shtuar të shpërdorimit të tij. Çdo organ kushtetues dhe pjesë përbërëse të tij kanë detyrimin t'i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve të vendit. Prandaj konsiderohet domosdoshmëri që parimi i ndarjes së pushteteve, pavarësisht ndryshimit të forcave politike në pushtet, të mbetet mbizotërues dhe të mos cedojë për arsye të papërligjura kushtetuese (*shih vendimet nr. 26, datë 25.05.2021; nr. 23, datë 24.04.2015; nr. 15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata evidenton se neni 117 i Rregullores ka parashikuar se çdo deputet ka të drejtë të paraqesë propozime për ndryshime në Rregullore dhe se këto ndryshime miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Bazuar në aktet e procedurës parlamentare, rezulton se kërkesa për ndryshimin e Rregullores është bërë nga 5 deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, ndër të cilët edhe kryetari i Grupit Parlamentar si

drejtues politik i tij, në cilësinë e propozuesit, për rrjedhojë është paraqitur nga subjekte të cilëve vetë Rregullorja ua ka dhënë tagrin për të kërkuar ndryshimin e saj. Për më tepër, Gjykata vëren se, sikurse ka prapësuar subjekti i interesuar, Kuvendi, fjalimi i Kryeministrit në detyrë, i pretenduar nga kërkuesi si ndërhyrje, është mbajtur në një aktivitet të partisë politike që sapo kishte fituar zgjedhjet parlamentare, në cilësinë e kryetarit të kësaj force dhe jo të kreut të pushtetit ekzekutiv, në ushtrim të së drejtës së tij për t'iu drejtuar anëtarëve të forcës së tij politike dhe për të deklaruar idetë politike të mandatit qeverisës. Pavarësisht natyrës së atyre deklaratave dhe pavarësisht faktit se deputetët kërkues i përkasin shumicës parlamentare, Gjykata nuk ka ndonjë shkak që të vërë në dyshim mënyrën e ushtrimit të së drejtës së atyre deputetëve për të kërkuar vënien në lëvizje të procedurës parlamentare në rastin konkret. Gjykata çmon se procedura e ndjekur ka natyrë parlamentare dhe është vënë në lëvizje nga anëtarët e organit legjislativ, për rrjedhojë nuk rezulton që kompetenca për propozimin e ndryshimeve në Rregullore të jetë ushtruar nga një organ i një pushteti tjetër, në cenim të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve. Në këtë kushte, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

24. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuesit, ato kanë të bëjnë me cenimin e *parimit të demokracisë përfaqësuese në drejtim të lirisë së shprehjes së deputetit*, për shkak se deputetëve të pakicës parlamentare u është hequr e drejta e fjalës për diskutimin e projektvendimit, në kundërshtim me të drejtat që burojnë nga statusi i deputetit; cenimin e parashikimeve kushtetuese dhe të Rregullores që rregullojnë *procedurën e shqyrtimit të përshpejtuar*, e cila, sikundër edhe afatet e saj, zbatohet në të njëjtën mënyrë në këtë rast sikundër në rastin e projektligjeve; *mënyrën e thirrjes së mbledhjes së Kuvendit*, në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe të Rregullores, të cilat synojnë të sigurojnë pjesëmarrjen e deputetëve dhe t'u garantojnë të drejtën për të kontribuar efektivisht në procesin ligjvënës.

25. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit në rastin konkret kanë të bëjnë me ushtrimin e së drejtës së fjalës, ndjekjen e procedurës së përshpejtuar dhe mënyrën e thirrjes së Kuvendit, për rrjedhojë ajo vlerëson t'i shqyrtojë ato të lidhura me parimin e demokracisë përfaqësuese, të parashikuar në nenin 2 të Kushtetutës, që parashikon ushtrimin e sovranitetit të popullit përmes përfaqësuesve të tij në drejtim të lirisë së shprehjes së deputetit si një nga aspektet e ushtrimit të funksionit përfaqësues. Në këtë drejtim, ajo do të verifikojë respektimin e këtij parimi edhe në këndvështrim të ekuilibrit të drejtë që duhet të ekzistojë mes tij dhe parimit të autonomisë së Kuvendit në kontekstin e miratimit nga ky i fundit të normave vetërregulluese për procedurat parlamentare për miratimin e akteve.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për cenimin e parimit të demokracisë përfaqësuese në drejtim të lirisë së shprehjes së deputetit

26. Sipas kërkuessit, jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, në kuadër të të drejtave që burojnë nga statusi i deputetit, nga Rregullorja, si dhe nga Kushtetuta, heqja e së drejtës së fjalës të deputetëve të pakicës parlamentare për diskutimin e projektvendimit për ndryshimin e Rregullores, cenon rëndë parimin e demokracisë përfaqësuese në drejtim të lirisë së shprehjes së deputetëve. Po sipas kërkuessit, është cenuar neni 78, pika 2, i Kushtetutës që parashikon se mbledhjet që thirren në kundërshtim me Rregulloren nuk sjellin asnjë pasojë. Në rastin konkret, parashtron ai, dispozita kushtetuese referon në dispozitat e Rregullores dhe sipas nenit 27/1, pika 3, të saj mbledhjet e Kuvendit njoftohen si rregull 7 ditë përpara, por në çdo rast jo më vonë se 2 ditë përpara datës së caktuar për seancë plenare. Kërkuessi ka pretenduar edhe cenimin e nenit 83, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 117 të Rregullores që lejojnë shqyrtimin dhe miratimin e një projektligji me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së përshpejtuar, parashikime që, sipas tij, zbatohen në të njëjtën mënyrë edhe për ndryshimin e Rregullores.

27. *Subjekti i interesuar, Kuvendi*, ka prapësuar se Kushtetuta dhe Rregullorja e bëjnë një dallim për sa i takon mënyrës së miratimit të projektligjeve dhe akteve të tjera ku përfshihen edhe projektvendimet si në rastin konkret. Sipas tij, edhe praktika e deritanishme parlamentare ka treguar se në disa raste janë bërë ndryshime pa u zhvilluar debat dhe në kohë relativisht të shkurtër si në rastin konkret. Fakti që deputetët e pakicës parlamentare nuk kanë qenë dakord me ndryshimet dhe me shpejtësinë e procesit, nuk përbën në vetvete një shkelje kushtetuese. Po sipas Kuvendit, ka një dallim konceptual midis thirrjes së mbledhjes sipas Rregullores dhe respektimit të afateve procedurale të njoftimit, pasi neni 78, pika 2, i Kushtetutës synon të sanksionojë rastet kur Kuvendi mblidhet pa u thirrur fare, kur mungon akti i thirrjes nga organi kompetent ose kur mbledhja zhvillohet pa kuorum ose jo në vendin e mbledhjes etj. Edhe për pretendimin për shkeljen e procedurës së shqyrtimit të përshpejtuar, Kuvendi ka prapësuar se nuk qëndron, pasi Rregullorja rregullon procedurën e përshpejtuar vetëm për projektligjet dhe se parashikimi i nenit 117 të saj nuk mund të lexohet si një imponim absolut i çdo detaji procedural të shqyrtimit të projektligjeve edhe në rastin e ndryshimit të Rregullores.

28. Parimi i demokracisë përfaqësuese buron nga neni 1, pika 2, i Kushtetutës, që parashikon se Shqipëria është republikë parlamentare, si dhe nga neni 2, pikat 1 dhe 2, i saj, që sanksionojnë sovranitetin si parim themelor të ekzistencës së shtetit, i cili i përket popullit, që

e ushtron nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti. Vullneti politik i popullit si bartës i sovranitetit shtetëror bëhet i realizueshëm kryesisht përmes përfaqësimit në Parlament dhe në këtë kuptim Kushtetuta, në nenin 70, parashikon se deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues. Nga parimi i demokracisë përfaqësuese rrjedh detyrimi i deputetit që mandatin e besuar nga zgjedhësit ta ushtrojë realisht (*shih vendimet nr. 48, datë 19.06.2024; nr. 31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Koncepti i mandatit parlamentar përmban detyrimin e përfaqësimit real të zgjedhësve. Populli merr pjesë në vendimmarrjen parlamentare nëpërmjet tërësisë së anëtarëve të tij dhe për këtë qëllim duhet të garantohet pjesëmarrja e të gjithë deputetëve në vendimmarrje sipas kuadrit kushtetues. Sipas Gjykatës, vetëm duke qenë plotësisht efektiv, pra duke iu mundësuar ushtrimi i përfaqësimit të gjithë anëtarëve të tij, parlamenti mund të realizojë funksionin e tij demokratik. Nëse një deputet, për arsye të ndryshme, ndalohet ose pengohet të ushtrojë funksionin e tij si pjesë e parlamentit, atëherë cenohet parimi i përfaqësimit, si dhe raporti shumicë/pakicë i vendosur nga vullneti i zgjedhësve dhe që duhet të gjejë patjetër pasqyrim në parlament gjatë gjithë legjislaturës (*shih vendimet nr. 48, datë 19.06.2024; nr. 1 datë 16.02.2022; nr. 44, datë 07.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Të drejtat që burojnë nga statusi kushtetues i deputetit, sipas nenit 70 të Kushtetutës, i parë së bashku me nenin 81, pika 1, të saj, janë zbërthyer në parashikimet e ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit” (*ligji nr. 8550/1999*) dhe ato të Rregullores së Kuvendit. Më konkretisht, sipas nenit 4 të ligjit nr. 8550/1999, deputeti merr pjesë rregullisht në seanca plenare, në komisione, si dhe në të gjithë veprimtarinë e Kuvendit, në përputhje me kërkesat e Rregullores. Ai ka të drejtë të ushtrojë vetë dhe në kuadrin e veprimtarisë së komisionit kontrollin e zbatimit të ligjeve, vendimeve e akteve të tjera të nxjerra nga Kuvendi, nga Këshilli i Ministrave, nga ministritë, nga organet e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe ka të drejtë të shprehë lirisht mendimet e tij dhe të zgjedhësve që ai përfaqëson nëpërmjet diskutimeve, propozimeve, debatit, interpelancave, pyetjeve, mocioneve, deklaratave dhe votës.

31. Në kuptim të të drejtave të deputetit që burojnë nga statusi i tij, liria e shprehjes gëzon një nivel të lartë mbrojtjeje, që reflektohet në parashikimin e imunitetit parlamentar sipas nenit 73, pika 1, të Kushtetutës. Kjo liri i shërben mbrojtjes së interesave të organit ligjvënës në tërësi dhe nuk duhet kuptuar thjesht si një mbrojtje që u ofrohet deputetëve individualisht. Liria e shprehjes së deputetëve në përgjithësi dhe në veçanti e deputetëve të opozitës merr rëndësi të madhe, ndaj, duke qenë ajo fjalë politike *par excellence*, ndërhyrja në këtë të drejtë

të anëtarit të parlamentit që vjen nga radhët e opozitës kërkon shqyrtim më të ngushtë nga Gjykata (*shih vendimin nr. 48, datë 19.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Megjithatë, edhe pse e drejta për të marrë pjesë në debatin parlamentar është një element i rëndësishëm i parlamentarizmit demokratik, ajo nuk garantohet pa asnjë kufizim, por mund të kufizohet për shkak të parimeve dhe vlerave të tjera të nivelit kushtetues, siç është ai i mirëfunksionimit të Kuvendit dhe i garantimit të aftësisë së tij për të funksionuar dhe ushtruar veprimtarinë (*shih vendimet nr. 48, datë 19.06.2024; nr. 1, datë 16.02.2022; nr. 44, datë 07.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhja midis një demokracie efektive politike dhe funksionimit efektiv të parlamentit kërkon gjetjen e ekuilibrit të duhur midis të drejtave të deputetëve individualë të opozitës dhe garantimit të veprimtarisë efektive parlamentare, duke pasur parasysh se duhet të merren në konsideratë edhe të drejtat e pakicës parlamentare, bazuar në konceptet e demokracisë përfaqësuese efektive dhe të shtetit të së drejtës. Në veçanti, duhet të arrihet një ekuilibër, i cili siguron trajtimin e drejtë dhe të duhur të njerëzve që vijnë nga pakicat dhe shmang abuzimin e një pozicioni dominues. Prandaj, me autonominë parlamentare nuk duhet të abuzohet, me qëllim shtypjen e lirisë së shprehjes së deputetëve dhe rregullat për funksionimin e brendshëm të parlamentit nuk duhet të shërbejnë si bazë që shumica parlamentare të abuzojë me pozitën e saj dominuese përballë opozitës (*shih vendimin nr. 48, datë 19.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Nga ana tjetër, në marrëdhënien mes dy parimeve që gëzojnë të njëjtën mbrojtje kushtetuese, ai i demokracisë përfaqësuese dhe ai i autonomisë parlamentare vetërregulluese, është e rëndësishme ruajtja e një raporti të drejtpeshuar që duhet të ekzistojë mes tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë parlamentare. Kështu, sipas nenit 75, pika 2, të Kushtetutës Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas Rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve të tij. E drejta për të miratuar rregullat e organizimit dhe të funksionimit është aspekt i autonomisë parlamentare, sipas së cilës parlamenti duhet të ketë të drejtën ekskluzive për të rregulluar organizimin e tij, rolin e deputetëve, strukturën dhe procedurat e brendshme. Megjithatë, Kuvendi, pavarësisht se gëzon një hapësirë të gjerë lirie për të vendosur rregullat e nevojshme, me qëllim vetorganizimin, nuk mund të kufizojë ushtrimin e të drejtave të deputetëve për shkaqe të ndryshme nga ato që kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarisë së tij në përputhje me parimin e funksionalitetit dhe efektivitetit apo me qëllim ruajtjen e dinjitetit të tij, si një nga vlerat përbërëse të rendit parlamentar. Pushteti vetërregullues nuk duhet të bëhet premisë që të drejtat e deputetëve të cenohen në atë masë që do të çonte drejtpërdrejt në cenimin e parimit të demokracisë përfaqësuese (*shih vendimin nr. 48, datë 19.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Gjykata, bazuar në standardet e mësipërme, si dhe në këndvështrim të argumenteve të parashtruara nga kërkuesi, vëren se pretendimi për cenimin e parimit të demokracisë përfaqësuese në këndvështrim të lirisë së shprehjes është mbështetur në dy aspekte kryesore të procedurës parlamentare: (i) mënyrën e thirrjes së Kuvendit, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të Kushtetutës; (ii) shpejtësinë e procedurës, në kundërshtim me nenin 83, pika 2, të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata, në vijim, do të verifikojë mënyrën e zbatimit të dispozitave kushtetuese dhe atyre procedurale që rregullojnë këto aspekte të procedurës parlamentare për t'i dhënë përgjigje pyetjes nëse deputetët janë penguar në ushtrimin e lirisë së shprehjes, të lidhur me debatin parlamentar, të drejtën e paraqitjes së amendamenteve dhe votimit të informuar, për të arritur kështu në përfundimin nëse është cenuar parimi i demokracisë përfaqësuese.

C.1.1. Për mënyrën e thirrjes së Kuvendit në seancë plenare

35. Gjykata vëren se në datën 15.09.2025 pesë deputetë të grupit parlamentar të shumicës parlamentare kanë propozuar disa ndryshime në Rregulloren e Kuvendit. Në po të njëjtën ditë (datë 15.09.2025) Kryetari i Kuvendit ka nxjerrë urdhrat nr. 1 dhe nr. 2 për rendin e ditës së seancës plenare të datës 16.09.2025 (për orën 10:00 dhe orën 17:00), duke ua komunikuar këto akte deputetëve në orën 16:28 të po asaj date. Në datën 16.09.2025, me mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare në orën 10:00, nga ana e Kryetarit të tij është bërë me dije kërkesa e 30 deputetëve të shumicës parlamentare për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektvendimit për ndryshimin e Rregullores, kërkesë kjo që është miratuar në vijim nga shumica parlamentare.

36. Sipas nenit 78 të Kushtetutës, Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar. Sipas pikës 2 të këtij neni, mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores nuk sjellin asnjë pasojë.

37. Gjykata rithekson se, bazuar në parimin e autonomisë parlamentare, mosrespektimi i Rregullores e bën veprimtarinë parlamentare antikushtetuese vetëm nëse janë prekur dispozita të nivelit kushtetues që gjejnë pasqyrim në të (*shih vendimet nr. 54, datë 09.07.2024; nr. 48, datë 19.06.2024; nr. 35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe pse veprimtaria parlamentare udhëhiqet nga parimi i autonomisë dhe i vetërregullimit, për disa aspekte të organizimit të funksionimit të Kuvendit dhe organeve të tij Kushtetuta ka përcaktuar në mënyrë të shprehur ato shkelje që e bëjnë jokushtetuese këtë veprimtari, siç është pasoja e parashikuar në pikën 2 të nenit 78 të Kushtetutës në rast të thirrjes së mbledhjeve jo sipas Rregullores.

Gjykata ka theksuar se kjo dispozitë zbatohet si për thirrjen e seancave plenare/mbledhjeve të deputetëve në Kuvend, ashtu edhe për thirrjen në mbledhjet e komisioneve parlamentare të përhershme (*shih vendimin nr. 6, datë 10.02.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Gjithashtu, koncepti kushtetues “thirrje e mbledhjes”, në rastin e seancës plenare, nuk duhet interpretuar në një mënyrë të ngushtë dhe literale, që do të prekte thelbin kushtetues të tij. Kushtetuta e ka ngritur respektimin e rregullave për thirrjen e mbledhjes në nivelin e një kushti *sine qua non* për vlefshmërinë e mbledhjeve të deputetëve në seancë plenare. Parashikimi i nenit 78, pika 2, të Kushtetutës nuk duhet të kuptohet thjesht dhe vetëm si një rregullim me natyrë procedurale, por si një premisë e rëndësishme për mirëfunksionimin e një organi kolegjal, me konfigurim politik siç është Kuvendi, me pasoja të drejtpërdrejta në cilësinë e parlamentarizmit në vend. Për këtë arsye, koncepti “thirrje e mbledhjes” përfshin të gjitha dispozitat që lidhen me mënyrën e caktimit të mbledhjes plenare, të krijimit të rendit të ditës dhe të njoftimit të kohës dhe vendit të mbajtjes së mbledhjes, të cilat parashikohen në Rregullore. Në këtë pikë duhet evidentuar se mënyra e funksionimit të Kuvendit duhet të udhëhiqet nga bashkëpunimi i sinqertë ose parimi i luajalitetit kushtetues, i cili ka të bëjë, në thelb, me respektin e ndërsjellë nga secili subjekt ndaj kompetencave të tjetrit, si dhe nënkupton krijimin e një raporti bashkëpunimi midis tyre. Siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, ky parim përfshin edhe detyrimin për sjellje koherente dhe jokontradiktore, pra palët nuk duhet të kenë qëndrime zvarritëse, bllokuese, të paqarta ose të pajustificuara, në mënyrë që bashkëpunimi midis tyre të jetë mbi baza mirëbesimi dhe korrektese, si dhe të jenë të hapura për qasjet e ndryshme të palës tjetër, por gjithnjë duke respektuar kompetencat që i janë dhënë secilës palë (*shih vendimin nr. 26, datë 25.05.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në këtë aspekt, për sa kohë që pasoja (mungesa e pasojave të mbledhjeve që mbahen pa u thirrur sipas Rregullores) është e parashikuar drejtpërdrejt nga Kushtetuta, e vetmja mënyrë e kontrollit të kësaj veprimtarie është mënyra sesi janë zbatuar në rastin konkret dispozitat e brendshme rregullatore të Kuvendit. Në këtë drejtim Gjykata vëren edhe se, sipas nenit 117 të Rregullores, për shqyrtimin e propozimeve për ndryshime në këtë akt ndiqet procedura e parashikuar prej saj për paraqitjen dhe shqyrtimin e projektligjeve.

40. Neni 78, pika 2, i Kushtetutës është një dispozitë referuese në dispozitat e Rregullores lidhur me mënyrën dhe procedurën e thirrjes së Kuvendit në seancë plenare. Ajo dispozitë plotësohet edhe nga neni 27/1 i Rregullores, që përcakton mënyrën e thirrjes së seancës dhe afatet e saj. Sipas kësaj dispozite, rendi i ditës i seancës plenare miratohet me urdhër të Kryetarit të Kuvendit dhe bëhet publik si rregull 7 ditë përpara, por jo më vonë se 2 ditë përpara datës së caktuar për seancën plenare, duke vendosur kështu afate maksimale dhe

minimale të qarta për thirrjen e seancës plenare. Për rrjedhojë, shkelja e kësaj dispozite të Rregullores materializohet me pavlefshmërinë e vet mbledhjes, duke përbërë një garanci thelbësore për ushtrimin e demokracisë parlamentare nga ana e deputetëve. Nga këto premisa, afatet e thirrjes së mbledhjes (seancës plenare) nuk janë thjesht formale, por përbëjnë garanci që mbledhjet e deputetëve të thirren sipas Rregullores, me qëllim ushtrimin e matur dhe në respektim të të drejtave të deputetëve të veprimtarisë parlamentare.

41. Duke mbajtur parasysh procedurën e ndjekur në rastin konkret për miratimin e ndryshimeve të Rregullores (*shih paragrafin 35 të vendimit*), Gjykata vëren se mbledhja e deputetëve është thirrur në të njëjtën ditë me paraqitjen e propozimit nga deputetët propozues dhe vetëm një ditë përpara seancës plenare, duke u lajmëruar deputetët nëpërmjet *e-maili*-it nga administrata e Kuvendit. Nga aktet e depozituara nga kërkuesi, nuk rezulton që deputetët e pakicës të kenë marrë dijeni për projektvendimin e depozituar nga deputetët e shumicës për ndryshimin e Rregullores, ndërkohë që lajmërimi kishte të bënte vetëm me çështjet e planifikuara për atë seancë, që konsistonin në njoftime të ndryshme, në zgjedhjen e organeve drejtuese të Kuvendit që kishin të bënin me zëvendëskryetarin, byronë e Kuvendit dhe sekretariatet e saj, si dhe me kryesitë e komisioneve të përhershme. Gjykata evidenton se deputetët e pakicës janë njohur me aktin (projektvendimin për ndryshimin e Rregullores) vetëm në momentin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga ana e 30 deputetëve të shumicës parlamentare për miratimin e tij me procedurë të përshpejtuar, pra në ditën kur ky akt është miratuar.

42. Gjithashtu, lidhur me mënyrën e thirrjes së Kuvendit në seancë plenare, Gjykata gjatë debatit gjyqësor konstatoi se lajmërimi për ndryshimin e rendit të ditës (ku ishte futur ndryshimi i Rregullores me procedurë të përshpejtuar) ishte bërë më pak se 24 orë nga zhvillimi i saj dhe pa iu vënë në dispozicion deputetëve ndryshimet konkrete, duke bërë që ata të njiheshin në seancë plenare me projektvendimin për ndryshimet e Rregullores. Lidhur me këtë fakt, subjekti i interesuar, Kuvendi, prapësoi se kjo lloj urgjence lidhej me nevojën për miratimin e akteve për procesin e integritetit në Bashkimin Evropian, ndërkohë që nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga vetë ai, rezulton se komisionet parlamentare janë konstituuar në datën 24.09.2025, ndërsa ligjet, të cilat në përmbajtje përafronin legjislacionin shqiptar me atë evropian, janë miratuar kohë më vonë. Këto fakte nuk e mbështesin prapësimin e Kuvendit, ndaj Gjykata nuk e konsideron të justifikuar nevojën e urgjencës.

43. Gjykata, në konsideratë të rrethanave konkrete të kësaj çështjeje, vlerëson se mënyra sesi është vepruar në rastin konkret për thirrjen e mbledhjes së deputetëve për miratimin e ndryshimeve të Rregullores ka vënë në pamundësi deputetët, në mënyrë të veçantë ata të

pakicës parlamentare, për të ushtruar lirisht të drejtat që u burojnë atyre nga statusi i deputetit. Vënia në dijeni e tyre vetëm ditën e seancës plenare për propozimin e deputetëve të shumicës për disa ndryshime në Rregullore, moment në të cilin ata janë njohur efektivisht edhe me përmbajtjen e ndryshimeve të propozuara, dhe në vijim mënyra e zhvillimit të procedurës parlamentare për shqyrtimin në po të njëjtën ditë të këtij propozimi, i përmbyllur me miratimin e tij me votat e shumicës parlamentare, ka bërë të pamundur ushtrimin prej tyre, duke i zhveshur, në thelb, nga këto të drejta. Kjo sjellje në rastin konkret, për shkak të mënyrës sesi janë interpretuar dhe zbatuar parashikimet e Rregullores për thirrjen e seancës plenare, u ka pamundësuar deputetëve të drejtën për të diskutuar dhe debatuar për çështjet e propozuara për ndryshim dhe për të paraqitur amendamente në lidhje me to, për sa kohë që pretendimet në lidhje me çështjet e procedurës parlamentare edhe pse u lejuan të ngrihen formalisht në thelb nuk u dëgjuan dhe nuk u morën në konsideratë, duke u pamundësuar kështu deputetëve të pakicës parlamentare të votojnë në mënyrë të informuar. Për rrjedhojë, mënyra e veprimit të Kuvendit në rastin konkret nuk është bërë në përputhje me parimin e luajtjes kushtetuese, duke sjellë cenimin e parimit të demokracisë kushtetuese.

C.1.2. Për miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit me procedurë të përshpejtuar

44. Sipas procesverbalit të seancës plenare të datës 16.09.2025, Kuvendi, me propozim të disa deputetëve të shumicës parlamentare, ka votuar fillimisht për kalimin e ndryshimeve në Rregulloren e tij me procedurë të përshpejtuar. Në lidhje me këtë votim kanë diskutuar fillimisht dy kryetarët e grupeve parlamentare të shumicës dhe pakicës parlamentare dhe më tej është kaluar në votimin e propozimit. Pas votimit, seanca është ndërprerë përkohësisht dhe projektvendimi i ka kaluar për shqyrtim Këshillit për Rregulloren. Ky Këshill, sipas procesverbalit, rezulton se është mbledhur menjëherë pas ndërprerjes së seancës në orën 12:00 dhe nga anëtarët e tij janë zhvilluar diskutime, ku janë angazhuar si deputetë të shumicës parlamentare, ashtu edhe të pakicës, të cilët kanë diskutuar si për procedurën e ndjekur, ashtu edhe për ndryshimet e propozuara. Këshilli për Rregulloren, po atë ditë, ka miratuar projektvendimin në parim, nën për nen dhe në tërësi, dhe i ka paraqitur Kryetarit të Kuvendit raportin (me dy qëndrime të kundërta) dhe projektvendimin bashkëlidhur atij për votim në seancë.

45. Po në atë datë (16.09.2025) Kuvendi është rimbledhur në seancë plenare për të votuar për ndryshimet në Rregullore. Me çeljen e seancës ka pasur diskutime kryesisht nga deputetë të pakicës (15 deputetë), por edhe të shumicës parlamentare, të cilat kishin të bënin

me procedurën e miratimit të ndryshimeve në Rregullore. Gjatë diskutimeve nga ana e Kryetarit të Kuvendit është ndërprerë fjala e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Shqipërisë, për shkak të përfundimit të kohës në dispozicion, fakt ky që ka sjellë reagime në sallë. Më tej është kaluar në votimin e projektvendimit, i cili është miratuar me 79 vota pro, 0 vota abstenim dhe 0 vota kundër.

46. Gjykata, sikurse është pohuar edhe më lart, vëren se neni 75, pika 2, i Kushtetutës përcakton se Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas Rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve. Kjo dispozitë e Kushtetutës përcakton funksionin rregullator të saj në raport me funksionimin e Kuvendit, përfshirë edhe funksionin ligjvënës të tij. Dispozita e mësipërme kushtetuese synon të garantojë në nivel kushtetues organizimin dhe funksionimin e Kuvendit në bazë të rregullave të paracaktuara, të cilat përfshijnë edhe rregullat e detyrueshme për zbatim në rastin e nismave për ndryshimin e vetë këtyre rregullave (nënkupto Rregullores).

47. Për sa i takon procedurës së përshpejtuar të miratimit të ligjeve, neni 83, pika 2, i Kushtetutës parashikon se Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një të pestës të të gjithë deputetëve, mund të shqyrtojë e të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit. Dispozita kushtetuese plotësohet nga neni 28 i Rregullores, ku detajohet kjo lloj procedure, duke përcaktuar mënyrën e paraqitjes së kërkesës, ashtu edhe atë të shqyrtimit të saj në seancë plenare.

48. Gjykata vlerëson të ritheksojë se në referim të nenit 117 të Rregullores, parashikimi i pikës 2 të nenit 83 të Kushtetutës është shterues lidhur me llojin e akteve që i nënshtrohen shqyrtimit të përshpejtuar, duke përfshirë edhe projektvendimin për ndryshimin e Rregullores. Ky përcaktim i Rregullores, në fuqi në kohën e ushtrimit të nismës për ndryshimin e Rregullores me procedurë të përshpejtuar, qartësisht e çon ndryshimin e saj në të njëjtin nivel me atë të ligjeve të tjera të cilat miratohen me procedurë të përshpejtuar, duke u bërë bazë për interpretimin edhe të pikës 2 të nenit 83 të Kushtetutës.

49. Gjykata vëren se pas rinisjes së seancës plenare, pakicës parlamentare i është dhënë mundësia e diskutimit në seancë lidhur me procedurën e ndjekur, ndërkohë që në diskutim janë përfshirë 15 deputetë të pakicës dhe disa deputetë të shumicës parlamentare që iu është dhënë fjala për procedurë, por jo për thelbin e ndryshimeve. Po ashtu, edhe në Këshillin për Rregulloren diskutimet kryesisht janë zhvilluar për procedurën e ndjekur, por pa u futur në diskutime për ndryshimet konkrete që do të pësonin komisionet e përhershme parlamentare.

50. Gjykata evidenton se për nga natyra e funksionit që kryen, Rregullorja luan një rol procedural të rëndësishëm në funksionimin e Kuvendit, duke vendosur kufijtë dhe modalitetet

e ushtrimit të veprimtarisë parlamentare. Parë në këtë këndvështrim, pavarësisht shumicës që nevojitet për miratimin e ndryshimeve të Rregullores, deputetët dhe sidomos pakica parlamentare duhet të kenë akses të mjaftueshëm në procesin e ndryshimit të saj. Aq më tepër, në kushtet kur shumica parlamentare e ka numrin e nevojshëm të deputetëve për miratimin e aktit, ajo duhet të dëshmojë vullnet për një kujdes të shtuar dhe frymë bashkëpunimi për të siguruar që pakica parlamentare të luajë një rol aktiv në procesin e shqyrtimit të projektaktit, duke ushtruar të drejtën e debatit për përmbajtjen dhe procedurën e tij, si dhe duke gëzuar mundësinë e propozimit të amendamenteve kur kjo shihet e arsyeshme, duke synuar që ndryshimet mundësisht të bëhen me vullnet të përbashkët dhe konsensual.

51. Në këtë mënyrë, në drejtim të garantimit të lirisë së shprehjes së deputetëve, si pjesë e rëndësishme e parimit të demokracisë përfaqësuese, Gjykata vlerëson se ndryshimi i këtij lloji akti (Rregullores), për vetë rëndësinë që përfaqëson, është barazuar nga vetë Kuvendi me procesin e shqyrtimit të projektligjeve në të gjitha aspektet që e karakterizojnë atë, përfshirë këtu të drejtën e debatit për thelbin e ndryshimeve, sikundër atë për paraqitjen e amendamenteve nga deputetët, duke përbërë kështu një garanci shtesë për pakicën parlamentare në ushtrimin e mandatit parlamentar. Për rrjedhojë, nga njëra anë, kjo liri dhe mënyra e ushtrimit të saj në përputhje me parashikimet e Rregullores nuk mund të lihet në diskrecionin ose interpretimin e Kryetarit të Kuvendit. Në këtë kuptim, kufizimi i së drejtës së fjalës ose heqja e saj deputetëve të pakicës parlamentare nga Kryetari i Kuvendit, që ka sjellë pamundësinë e ushtrimit në një kohë të arsyeshme të të drejtave të tyre kushtetuese, vlerësohet edhe se është në tejkalim të kompetencave të tij funksionale dhe bie ndesh me nenet 70, pika 1 dhe 75, pika 2, të Kushtetutës. Këto parashikime kushtetuese, të para të lidhura edhe me parashikimet e Rregullores dhe të ligjit nr. 8550/1999, nuk vendosin kufizime substanciale ose përjashtime kategorike të së drejtës së fjalës së deputetit. Përkundrazi, Rregullorja në nenet 46 dhe 48 të saj parashikon të drejtën e deputetëve për të diskutuar pa vendosur kufizime që lidhen me llojin e veprimtarisë ose të aktit që po shqyrtohet nga Kuvendi, ndërsa neni 4 i ligjit për statusin e deputetit sanksionon të drejtën e fjalës së deputetit në funksion të procesit legjislativ për të gjitha projektaktet e Kuvendit.

52. Nga ana tjetër, votimi me procedurë të përshpejtuar për miratimin e dispozitave të Rregullores, të cilat kanë ndryshuar numrin dhe fushën e përgjegjësisë të komisioneve të përhershme parlamentare, pa u dhënë deputetëve të pakicës parlamentare mundësinë për t'u njohur paraprakisht me përmbajtjen e projektvendimit, tejkalon diskrecionin e Parlamentit në organizimin e procedurave parlamentare dhe nuk arrin një ekuilibër të drejtë midis parimit të autonomisë parlamentare dhe atij të demokracisë përfaqësuese. Pa komunikimin e

projektakteve, realizimi i të drejtave të tjera të anëtarëve të Parlamentit, siç është ajo për të paraqitur propozime dhe amendamente alternative, si dhe për të debatuar mbi projektaktin, bëhet iluzore. Për më tepër, me qëllim që deputetëve t'u sigurohet mundësia për të njohur përmbajtjen e projektakteve të Parlamentit, atyre duhet t'u jepet një periudhë e arsyeshme kohore, e përcaktuar edhe në Rregullore, për t'i analizuar ato dhe për të formuar një mendim mbi to. Në këtë analizë merr rëndësi edhe fakti që pushteti vetërregullues i Kuvendit nuk duhet të bëhet premisë që të drejtat e deputetëve të cenohen në atë masë që do të çonte drejtpërdrejt në cenimin e parimit të demokracisë përfaqësuese, siç vlerësohet se ka ndodhur në rastin në shqyrtim.

53. Mbi këto premisa, Gjykata çmon se në rastin konkret pakica parlamentare është penguar të ushtrojë funksionet e saj si pjesë e Parlamentit, çka ka sjellë cenim të mandatit përfaqësues të deputetit, si dhe të raportit shumicë/pakicë të vendosur nga vullneti i zgjedhësve dhe të mishëruar edhe në rregullat e organizimit dhe funksionimit të Kuvendit, të cilat ishin miratuar dhe ishin në fuqi përpara ushtrimit të nismës për ndryshimin e Rregullores. Në këtë kuadër, rezulton se është cenuar parimi i demokracisë përfaqësuese, i cili i garanton çdo anëtar të Kuvendit që të ushtrojë, gjatë veprimtarisë parlamentare, të drejtat që burojnë nga statusi i tij kushtetues, i përcaktuar në nivel kushtetues lidhur me lirinë e shprehjes dhe jo vetëm, për shkak se pengimi është evidentuar edhe në drejtim të rolit substancial të pakicës parlamentare për të paraqitur amendamente dhe ndryshime në projektvendimin për ndryshimin e Rregullores, si pasojë e mosrespektimit të afateve minimale të kërkuara që u mundësojnë deputetëve që të reflektojnë dhe prodhojnë nisma të tilla, duke sjellë në këtë mënyrë asgjësimin e këtyre të drejtave në këtë proces.

54. Thënë sa më sipër, Gjykata çmon se mënyra e thirrjes së Kuvendit në seancë plenare, si dhe procedura e përshpejtuar e miratimit të ndryshimeve të Rregullores kanë sjellë cenimin e parimit të demokracisë përfaqësuese në drejtim të lirisë së shprehjes së deputetëve të pakicës parlamentare. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuar në këtë drejtim është i bazuar.

55. Gjykata vlerëson që efektet e këtij shfuqizimi të hyjnë në fuqi 30 ditë pas botimit të vendimit në Fletoren Zyrtare, në mënyrë që gjatë kësaj periudhe kohore Kuvendi të ketë mundësinë e organizimit të komisioneve parlamentare sipas standardeve për procedurën e miratimit të akteve, të përcaktuar në arsyetimin e mësipërm të këtij vendimi.

56. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuar për cenimin e parimit të demokracisë përfaqësuese në drejtim të lirisë së shprehjes janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 124, 131 dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 57/2025, datë 16.09.2025 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Efektet shfuqizuese të këtij vendimi hyjnë në fuqi 30 ditë nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 23.02.2026

Shpallur më 20.04.2026

A N Ë T A R E

/Sonila Bejtja/ (d.v.)

A N Ë T A R E

/Marsida Xhaferllari/ (d.v.)

K R Y E T A R E

/Fiona Papajorgji/(d.v.)

A N Ë T A R E

/Marjana Semini/ (d.v.)

A N Ë T A R

/Genti Ibrahimi/ (d.v.)

A N Ë T A R

/Ilir Toska/ (d.v.)

A N Ë T A R

/Sandër Beci/ (d.v.)

A N Ë T A R

/Asim Vokshi/ (d.v.)

Vërtetohet njësia me origjinalin

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Eugen PAPANDILE

MENDIM PARALEL

1. Në shqyrtimin e çështjes nr. 6 (j) 2025 që i përket kërkesës së subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, me objekt *“Shfuqizimi i vendimit nr. 57/2025, datë 16.09.2025 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pezullimi i vendimit nr. 57/2025, datë 16.09.2025 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”, deri në dhënien e një vendimi përfundimtar.”*, edhe pse i bashkohem shumicës në lidhje me zgjidhjen e saj, pra për pranimin e kërkesës, qëndrimi im bazohet në një qasje të ndryshme lidhur me juridiksionin e Gjykatës për kontrollin kushtetues të procedurës për ndryshimin e Rregullores së Kuvendit, në koherencë me atë që kam mbajtur më parë në çështje tjetër (shih mendimin kundër në vendimin nr. 48, datë 19.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese). Për rrjedhojë, në vijim, do të parashtroj argumentet e mia.

2. Për sa i përket juridiksionit të Gjykatës për shqyrtimin e Rregullores edhe pse pajtohem me përfundimin e arritur nga shumica se Gjykata ka juridiksion për gjykimin e çështjes, nuk pajtohem me shkaqet mbi të cilat ajo ka arritur në këtë përfundim, pasi vlerësoj se ky juridiksion buron drejtpërdrejt nga përmbajtja e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës. Kjo sepse Rregullorja, edhe pse nuk është tipikisht dhe formalisht një ligj, në thelb dhe në përmbajtje përbën aktin mbi të cilin organizohet dhe funksionon Kuvendi, pra barazohet me ligjin organik të këtij organi. Gjykata ka theksuar se në ndryshim nga organet kushtetuese, organizimi dhe funksionimi i të cilave rregullohen me ligje të veçanta të miratuara me shumicë të cilësuar (nenet 6 dhe 81, pika 2, shkronja “a”, të Kushtetutës), Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas Rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve të tij (neni 75, pika 2, i Kushtetutës). E drejta e Kuvendit për të miratuar rregullat e organizimit dhe të funksionimit të tij ka të bëjë me autonominë procedurale (normative dhe organizative) të këtij organi, i cili ka të drejtën ekskluzive për të rregulluar organizimin e tij, rolin e deputetëve, strukturën dhe procedurat e brendshme (shih vendimin nr. 1, datë 16.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese). Fakti që Kushtetuta e ka parashikuar drejtpërdrejt, në nenin 75 të saj, aktin me të cilin Kuvendi do të rregullojë organizimin dhe veprimtarinë e tij, nënkupton se ajo e ka ngritur Rregulloren në nivelin e ligjit, duke i njohur një status të veçantë dhe të ndryshëm nga ato të akteve të këtij lloji (rregullore) që miratohen nga organet e tjera. Për rrjedhojë, duke qenë se Rregullorja

barazohet me ligjin organik të Kuvendit, ajo i nënshtrohet kontrollit kushtetues nga kjo Gjykatë ashtu si edhe çdo ligj tjetër sipas nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës.

3. Duke i qëndruar kësaj qasjeje në drejtim të juridiksionit të Gjykatës unë kam mbajtur qëndrimin, në vijim, se edhe kontrolli që Gjykata ushtron në këtë rast është pikërisht i njëjtë me atë që ushtrohet në rastet e kontrollit abstrakt të ligjeve që kufizojnë të drejta dhe liri kushtetuese. Për rrjedhojë, e gjej të sforcuar qasjen e Gjykatës që i ka lidhur pretendimet e kërkuarit me parimin e demokracisë parlamentare. Po kështu, sipas nenit 51 të Ligjit Organik të Gjykatës, gjatë shqyrtimit të kërkesave të parashikuara nga nenet 49 e 50 të këtij ligji, Gjykata vlerëson: a) përmbajtjen e ligjeve dhe të akteve normative; b) formën e ligjeve dhe të akteve normative; c) procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të tyre. Në këtë kuptim, për sa kohë që bëhet fjalë për ushtrimin e kontrollit abstrakt të një ligji organik, Gjykata vlerëson edhe verifikimin e pretendimeve për respektimin e procedurës parlamentare.

4. Për rrjedhojë, në lidhje me pretendimet për mënyrën e thirrjes së Kuvendit në kundërshtim me nenin 78, pika 2 të Kushtetutës si dhe shpejtësinë e procedurës në kundërshtim me nenin 83, pika 2 të Kushtetutës, vlerësoj, ndryshe nga arsyetimi i shumicës, se ato bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues pa pasur nevojë që të trajtohen të lidhura me parime të tjera kushtetuese.

A N Ë T A R E

/Sonila Bejtja/ (d.v.)

Vërtetohet njësia me origjinalin
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Eugen PAPANDILE